



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2024:180041  
Datë: 21.01.2025  
Numri i dokumentit: 06736679

C.nr.1486/2024

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, me gjyqtarin Nazmi Neziri me bashkëpunëtorin profesional Mensur Avdullahu në çështjen juridike - civile të paditëses A. H. nga P., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit avokati B. F. A., nga P., Blv. "B. K.", Bll...., Llam..., nr. ... – D., kundër të paditurës Komuna e Podujevës, Drejtoria Komunale e Arsimit nga Podujeva, Rruga "N. G." pn., baza e kontestit: për shkak të kompensimin e orëve shtesë gjatë vitit shkollor 2022/2023, vlera e kontestit: e pa përcaktuar, jashtë seancës me datë 21.01.2025, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**KONSIDEROHET** se është tërhequr padia e paditëses A. H. nga P., kundër të paditurit Komuna e Podujevës, Drejtoria Komunale e Arsimit nga Podujeva, Rruga "N. G." pn., lidhur me çështjen për kompensimin e orëve shtesë gjatë vitit shkollor 2022/2023.

**A r s y e t i m**

Paditësja A. H. nga P., të cilën e përfaqëson sipas autorizimit avokati B. F. A., nga P., Blv. "B. K.", Bll...., Llam...., nr....– D., me aktvendimin e kësaj gjykate C.nr.1486/2024 të dt.11.12.2024, është ftuar që ta bëjë rregullimin e padisë në aspektin objektiv dhe atë: të bëjë rregullimin e petivitumit të padisë duke e përcaktuar qartë kërkesëpadinë me të cilën do të saktësojë shumën e kërkuar për secilën kërkesë, Të përcaktoj vlerën e kontestit, Të përcaktoj periudhën brenda të cilës kërkon kompensimin, Ti dorëzojë provat e cekura në padi për vërtetimin e fakteve.

Nga shkresat e lëndës shihet se të njëjtin aktvendim paditësi-i autorizuari i tyre e ka pranuar më dt.09.01.2025, siç vërtetohet nga fletë kthesa në shkresat e lëndës.

Bazuar si më lartë pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata konstatoi se për objektin e kontestit nuk ekziston më interes juridik, pasi që paditësi në afatin e caktuar nga gjykata (dhe deri në momentin e nxjerrjes së këtij aktvendimi), nuk e ka paraqitur padinë e përmirësuar-plotësuar në aspektin objektiv siç është kërkuar me aktvendimin e cituar, andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në kuptim të dispozitave të nenit 102.3 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK-së), e konsideroi të tërhequr padinë.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, Departamenti i përgjithshëm**

**C.nr. 1486/2024 të datës 21.01.2025**

**Gjyqtari:**  
Nazmi Neziri

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesë në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimet të këtij aktvendimi, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj Gjykate.